



## **VENDIMI dhe GJETJET**

**Data e miratimit: 21 prill 2015**

**Lëndët nr. 2013-05; 2013-06; 2013-07; 2013-08; 2013-09; 2013-10;  
2013-11, 2013-12; 2013-13; 2013-14**

**K, L, M, N, O, P, Q, R, S & T (K deri te T)**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 21 prill 2015, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar  
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga  
Z. John J. Ryan, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **PROCEDURA**

1. Ankesat K dhe T janë regjistruar më 7 qershor 2013.
2. Me qëllim të mbrojtjes së sigurisë, jetës private dhe identitetit të ankuesve, Paneli ka vendosur, *proprio motu*, që t'i referohet ankuesve si K, L, M, N, O, P, Q, R, S & T.

3. Më 8 Prill 2014, Paneli ka vendosur që të njoftoj shefin e Misionit (ShM) të EULEX-it Kosovë rreth ankesës, duke e ftuar atë të parashtrij komente me shkrim lidhur me ankesat.
4. Paneli ka komunikuar ankesat K - T në grup, pa cenuar mundësinë që më vonë të urdhëroj bashkimin formal të lëndëve sipas rregullës 20 të rregullores së punës. Po ashtu është vendosur të shqyrtohen meritat e aplikacionit në të njëjtën kohë me pranueshmërinë e tij (Rregulla 30 paragrafët 1 dhe 2 të rregullores së punës së Panelit, në vijim si RrP).
5. Vërejtjet e ShM janë pranuar më 6 qershor 2014, të cilat më pas janë përkthyer dhe komunikuar ankuesve për vërejtjet e tyre shtesë.
6. Më 18 shtator 2014, ankuesit kanë dërguar vërejtjet e tyre shtesë, të cilat janë dërguar te ShM për informim. Nuk janë kërkuar vërejtje të tjera.
7. Në këtë mënyrë Paneli urdhëron bashkimin formal të këtyre dhjetë lëndëve (K - T) në pajtim me rregullën 20 të rregullores së punës.

## **FAKTET**

### **I. RRETHANAT E LËNDËS**

8. Paneli nuk ka bërë përpjekje për të përcaktuar se kush ka kryer keqtrajtimin e dyshuar, e as nuk ka verifikuar nëse të gjitha pretendimet e bëra nga palët mund të vërtetohen në mënyrë të pavarur. Paneli ka kufizuar vendimet e tij faktike në atë që ishte e nevojshme dhe e rëndësishme për të vendosur rreth kësaj çështje.

### **Parashtrirat e ankuesve**

9. Më 7 janar 2013, ankuesit kanë ardhur nga Leposaviqi në manastirin e Graçanicës për të marrë pjesë në liturgjinë e krishtlindjes.
10. Pas përfundimit të liturgjisë, ata kanë shkuar në ndërtesën e "Radio Graçanicës", ku duhej të takoheshin me disa miq për të organizuar kthimin e përbashkët për në Leposaviq. Atje, ankuesve iu ishin afrua zyrtarë të Policisë së Kosovës (PK) dhe i kishin kërkuar që të tregonin dokumentet e identifikimit. Pas kontrollit të dokumenteve të tyre, zyrtarët e PK-së i kanë urdhëruar ankuesit që t'i shoqëronin në stacionin e policisë, gjoja për shkak se ata nuk kanë kartat e identitetit të Kosovës. Njëri nga zyrtarët e PK-së ka thënë se Policia do ta përdorte forcën, nëse do të ishte e nevojshme.
11. Në Stacionin Policor në Graçanicë, PK-ja ka kontrolluar tërësisht ankuesit dhe makinat e tyre. Pas kësaj, *"pa asnjë shpjegim, ne jemi privuar nga liria, ata na prangosën dhe na ka dërguar në stacionin nr.2 të Policisë në Prishtinë"*.

12. Ankuesit deklarojnë se *“gjatë gjithë kohës”* (në paraburgim) *ne ishim keqtrajtuar fizikisht dhe mentalisht. Në stacionin policor ne u rrahëm, ata na quanin me emra fyes, nuk na është lejuar të përdornin tualetin dhe nuk na kanë dhënë ujë*”. Vonë atë mbrëmje, ankuesit u transferuan në Stacionin Policor Qendra, ku kaluan natën në paraburgim pa ujë dhe ushqim. Sipas ankuesve, në atë kohë një numër gazetarësh dhe pjesëtarësh të policisë së EULEX-it ishin të pranishëm në hyrje të stacionit të policisë.
13. Të nesërmen në mëngjes, ankuesit u urdhëruan që të dilnin prej qelive të tyre të paraburgimit nga pjesëtarët e Njësisë Rajonale për Mbështetje Operative (ROSU). Pastaj ankuesve u janë vënë prangat. Pas kësaj, ankuesit pohojnë se *“disa nga 15 prej tyre [ROSU] na rrahën, na goditën me objekte të ndryshme, na pështynin, shanin dhe kjo ka vazhduar në automjet gjatë gjithë rrugës drejt gjyatës, kur ata morën armët dhe na kërcënuan [një prej ankuesve] se ata do të na vrisnin nëse ai nuk thotë se “Kosova është shtet i pavarur”*. Pastaj ankuesit u sollën para gjykatës. Ankuesit u “liruan nga të gjitha akuzat”. Megjithatë, ata nuk kanë dhënë ndonjë hollësi mbi akuzat e pretenduara. Ata nuk kanë ofruar dokumente në lidhje me paraburgimin e tyre apo procedurat gjyqësore pasuese. Duket se ata nuk posedojnë asgjë nga to.
14. Ankuesit deklarojnë se për një periudhë prej 48 orësh (nga data 7-8 janar 2013) ata janë keqtrajtuar brutalisht dhe se njëri prej tyre *“ishte në ndërtesën e gjykatës, përkatësisht në tualet, i rrahur aq shumë nga anëtar i ROSU-së, sa që i është dashur të transportohej urgjentisht drejt qendrës klinike spitalore në Beograd për shkak të seriozitetit të lëndimeve të tij*”. Ankuesit e tjerë janë trajtuar në spitalin e Mitrovicës dhe kanë ofruar dokumentacion të hollësishëm mjekësor në lidhje me këtë trajtim mjekësor.
15. Ankuesit deklarojnë se ata janë *“të bindur se EULEX-i ishte në dijeni rreth çdo gjëje që po ndodhte, që nga keqtrajtimi fizik dhe mendor dhe që nga fillimi kur kemi ardhur në Graçanicë, pasi që në disa raste e kemi parë stafin e tij*”. Po kështu, publiku i përgjithshëm është informuar për arrestimin e “serbëve” në Prishtinë, *“prandaj pjesëtarët e Misionit të EULEX-it mund të supozonin se ka pasur mundësi që ne të mund të keqtrajtoheshim, marrë parasysh situatën politike të sigurisë në Kosovë*”.
16. Ankuesit pohojnë se EULEX-i paraprakisht e dinte për festimet e krishtlindjeve ortodokse serbe dhe për këtë arsye duhej të kishte marrë masa parandaluese shtesë të sigurisë, duke pasur parasysh se në atë ditë një numër i konsiderueshëm i njerëzve nga e gjithë Kosova kanë vizituar manastirin e Graçanicës. Ata më tej pohojnë se *“EULEX-i ka qenë gjatë gjithë kohës neutral dhe i paimtësuar, kështu që mosveprimet e tij kanë kontribuar në shkëlqimin e të drejtave tona themelore dhe lirive të njeriut*”.

## Parashtrirat dhe përfshirja e EULEX-it

17. Zyrtarët policor të EULEX-it ishin të ngarkuar që ta shoqëronin konvojin e A.V., shef i zyrës së qeverisë së Serbisë për Kosovë gjatë qëndrimit të tij në Kosovë. Ai mori pjesë në festimet në manastirin e Graçanicës më 7 janar 2013. Zyrtarët policor të EULEX-it shoqëruan atë për në manastir, mirëpo nuk ishin të pranishëm gjatë liturgjisë, me qëllim që të takonin A.V. më pas në orën 14.00.
18. Zyrtarët e EULEX-it nuk kanë qenë dëshmitar të arrestimit të ankuesve. EULEX-i ishte njoftuar për këtë brenda një ore nga PK-ja. Sipas informacionit të dhënë në atë fazë nga ana e PK-së, ankuesit kanë qenë të veshur me rroba të zeza “që ngjanin me uniformë”. Kjo ka bërë që PK-ka të besoj se ata i përkisnin ekipit të sigurisë së A.V. Ankuesit janë dërguar në Njësinë për Hetime Rajonale të PK-së në Prishtinë për t’u identifikuar dhe verifikuar. Atyre ju ishin caktuar avokatë mbrojtës dhe ishin intervistuar si të dyshuar.
19. Zyrtarët policor të EULEX-it që shoqëronin A.V. po ashtu kanë mësuar rreth arrestimit, atëherë kur u kthyen në manastir rreth orës 12:30.
20. Në të njëjtën ditë dy zyrtarët policor të EULEX-it nga divizioni i përforsimit kanë vizituar njësinë rajonale të hetimeve. Zyrtarët e EULEX-it më tej kanë monitoruar PK-në, pasi ata i procesuan ankuesit, duke i informuar për të drejtat e tyre, duke marrë fotografi dhe shenjat e gishtave të tyre dhe duke i marrë në pyetje. Pas kësaj, paraburgimi ishte autorizuar nga një prokuror. As ankuesit e as EULEX-i nuk i kanë dhënë Panelit ndonjë informacion mbi atë se çfarë ishte natyra e dyshimeve kundër ankuesve.
21. Zyrtarët e EULEX-it ka vlerësuar se ankuesit ishin trajtuar mirë dhe të drejtat e tyre janë respektuar. Ata ishin gjithashtu të kënaqur që rasti ishte trajtuar në mënyrë profesionale dhe të shpejtë.
22. Më 8 janar 2013 ankuesit janë sjellë në Gjykatën e Prishtinës për Kundërvajtje. Dy zyrtarë policor të EULEX-it janë dërguar në gjykatë për të monitoruar situatën. Ata ishin të pranishëm në seancat e dy ankuesve. Ankuesit nuk kanë shfaqur shenja të shqetësimit apo ndonjë gjë që mund të shqetëson. Ata në asnjë mënyrë nuk kanë përmendur asgjë se janë duke u keqtrajtuar apo nuk kanë shfaqur shenja të lëndimit. Parashtrimet e palëve nuk ofrojnë asnjë hollësi mbi vendimet e marra nga gjykata.
23. Në të njëjtën mbrëmje pas seancave, ankuesit janë liruar nga paraburgimi dhe dy prej tyre u dërguan menjëherë në veri nga avokatët e tyre mbrojtës për të kërkuar trajtim mjekësor. Kjo ishte kur EULEX-i është informuar për gjoja keqtrajtimin e tyre dhe kishte përcjellë këtë informacion nëpërmjet hierarkisë së EULEX-it. Disa zyrtarë policor të EULEX-it nga divizioni i përforsimit kanë shkuar në manastirin e Graçanicës për t’i takuar ankuesit e tjerë. Ata i shpjeguan

atyre se qëllimi i vizitës së tyre ishte të mbledhin informacion, e jo dëshmi për hetim penal dhe se çfarëdo ankese në lidhje me keqtrajtimin e tyre duhet të adresohet në inspektoratin policor të Kosovës.

24. Ankuesit kanë shpjeguar se ata nuk kishin ankesa ndaj zyrtarëve të PK-së, të cilët kishin kryer arrestimin e tyre. Gjatë pjesës më të madhe të qëndrimit të tyre në njësinë rajonale të hetimeve ata ishin trajtuar mirë. Rrahjet kishin filluar para se të silleshin në gjykatë. Ata u sollën në katin lartë një nga një. Aty zyrtarët policor i kanë pritur ata duke i grushtuar dhe shkëlmuar. Pastaj ata u transportuan në gjykatë, ku njëri prej ankuesve ishte rrahur përsëri në banjo. Ankuesit besonin se kryesit e veprës i përkisnin ROSU-së së PK-së. Zyrtarët e EULEX-it kanë vënë në dukje se asnjë ankues nuk ka pasur lëndime të dukshme që rezultonte nga rrahjet. Ata kishin refuzuar të kontrolloheshin nga mjekët e EULEX-it.
25. Zyrtarët e EULEX-it kanë vënë në dukje se ju kanë frikësuar ndonjë kontakti tjetër me PK-në dhe dukeshin skeptik për ta kontaktuar Inspektoratin e Policisë. Megjithatë, ata duken të kënaqur me ndërveprimin e tyre me EULEX-in dhe në mënyrë të qartë kanë shprehur mirënjohjen e tyre për angazhimin e tyre.
26. Njëri nga zyrtarët e EULEX-it ka folur me homologun e tij në PK dhe ka mësuar se asnjë rast zyrtar lidhur me keqtrajtimin e dyshuar nuk ishte i hapur. Ai ka këshilluar PK-në se në qoftë se është e vërtetë, një keqtrajtim i tillë ka përbërë vepër të rëndë penale dhe shkelje të të drejtave të njeriut.
27. Zyrtarët policor të EULEX-it kanë shoqëruar ankuesit në Mitrovicën e veriut në ditën në vijim. Pastaj ata kanë vizituar një prej ankuesve, i cili ishte shtruar në spital atje. Ai nuk kishte pranuar të japë deklaratë, por i ka dhënë mjekut të tij dhe anëtarëve të familjes së tij leje për të folur me EULEX-it. Ata deklaruan se ankuesi kishte pësuar dëme të rënda në organet e tij të brendshme, si pasojë e rrahjeve në stacionin e policisë.
28. Dokumentacioni i mbledhur gjatë atyre ngjarjeve më pas iu është dërguar divizionit ekzekutiv të EULEX-it.
29. Inspektorati Policor i Kosovës ka nisur një hetim rreth ngjarjeve. EULEX-i ka caktuar një prokuror për ta trajtuar atë. Hetimi më pas është drejtuar nga një prokuror ndërkombëtar nga zyra e prokurorisë themelore dhe është trajtuar nga një ekip i përbashkët i hetuesve të Inspektoratit Policor dhe policisë së EULEX-it.
30. Më 11 dhjetor 2013, njëmbëdhjetë pjesëtar të Njesisë së Operacioneve Speciale të Policisë së Kosovës (ROSU) janë akuzuar për keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare, sulm dhe kërcënim. Procedurat kundër tyre janë ende të pazgjidhura në Gjykatën Themelore të Prishtinës.

## II. LIGJI PËRKATËS NË FUQI

### Veprimi i përbashkët

31. Nenet 2 dhe 3 të Veprimit të Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008 rreth Misionit Evropian mbi Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i në KOSOVË (më tutje: Veprimi i Përbashkët), thotë si më poshtë:

#### Neni 2 Deklarata e Misionit

EULEX-i në Kosovë do të ndihmojë institucionet e Kosovës, autoritetet gjyqësore dhe agjencitë për zbatimin e ligjit në përparimin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies, dhe në zhvillimin dhe forcimin e një sistemi të pavarur shumë-etnik të drejtësisë, policisë dhe shërbimit doganor, duke siguruar se këto institucione nuk iu nënshtrohen ndërhyrjeve politike dhe përfillin standardet e njohura ndërkombëtare dhe praktikat më të mira evropiane.

EULEX-i në KOSOVË, në bashkëpunim të plotë me Programin për Ndihmë të Komisionit Evropian, do ta përmbushë mandatin e tij përmes monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit, duke ruajtur përgjegjësi të caktuara ekzekutive.

#### Neni 3 Detyrat

Në mënyrë që të përmbushet Deklarata e Misionit e përcaktuar në Nenin 2, EULEX-i në Kosovë do të:

(a) monitorojë, udhëzojë dhe këshillojë institucionet kompetente të Kosovës në të gjitha fushat që ndërlidhen me sundimin e ligjit (përfshirë shërbimin doganor), përdërisa i ruan disa përgjegjësi të caktuara ekzekutive;

...

(d) të sigurojë që rastet e krimeve të luftës, terrorizmit, krimit të organizuar, korrupsionit, krimit ndëretnik, krimit financiar/ekonomik dhe krimeve tjera të rënda të hetohen, ndiqen, gjykohen dhe zbatohen siç duhet, sipas ligjit në fuqi, përfshirë, kur është e përshtatshme, nga hetues, prokurorë dhe gjykatës ndërkombëtarë së bashku me hetuesit, prokurorët dhe gjykatësit e Kosovës ose në mënyrë të pavarur, dhe përmes masave duke përfshirë, nëse ka nevojë, krijimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të strukturave ndërmjet autoriteteve policore dhe të prokurorisë;

(e) kontribuojë në forcimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit gjatë tërë procesit gjyqësor, veçanërisht në fushën e krimit të organizuar;

(f) kontribuon në luftën kundër korrupsionit, mashtrimit dhe krimit financiar;

## III. ANKESAT

32. Ankuesit pretendojnë se janë shkelur nenet e mëposhtme të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore të Njeriut (Konventa):

- Neni 3 i Konventës (ndalimi i torturës, trajtimit çnjerëzor ose degradues);
- Neni 5 i Konventës (të drejtës për liri dhe siguri);
- Neni 9 i Konventës (liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë);
- Neni 14 i Konventës (ndalimi i diskriminimit).

## LIGJI

33. Ankuesit pretendojnë se veprimet e EULEX-it kanë shkelur nenit 9 dhe nenit 2 të Protokollit Nr. 4 të Konventës. Në këto dispozita, për aq sa janë përkatëse, thuhet:

### Neni 3

Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.

### Neni 5

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijojnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj:

....

(c) kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent pas dyshimit të arsyeshëm se ka kryer një vepër penale ose kur në mënyrë të arsyeshme çmohet e nevojshme për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;

....

2. Çdo person i arrestuar duhet të informohet brenda një afati sa më të shkurtër dhe në një gjuhë që ai e kupton për arsyet e arrestimit të tij dhe në lidhje me çdo akuzë që i bëhet.

3. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1 (c) të këtij neni duhet të çohet menjëherë përpara një gjyqtari ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në pritje të gjykimit. Lirimi mund të kushtëzohet me dhënien e garancive për t'u paraqitur në procesin gjyqësor.

.....

### Neni 9:

"1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose besimin dhe lirinë, qoftë individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht nëpërmjet kultit, mësimdhënies, praktikave dhe kryerjes së riteve.

2. Liria e shfaqjes së fesë ose besimeve të dikujt nuk mund t'i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

### Neni 14

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si gjinia, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një pakicë kombëtare, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

## Parashtrimet nga palët

34. Në parashtrimet e tij, ShM deklaroi se nuk është e diskutueshme se ankuesit ishin të privuar nga liria. Megjithatë ai pohoi se instrumentet ndërkombëtare dhe legjislativi i Kosovës lejon që një person të jetë i privuar nga liria e tij për shkak të dyshimit të një krimi. Në rastin në fjalë, ankuesit janë arrestuar nën dyshimin e veprimtarisë kriminale dhe nuk ka asgjë për të sugjeruar se zyrtarët që kanë kryer arrestimin me të vërtetë nuk kanë dyshuar se ankuesit kishin kryer atë. Zyrtarët e EULEX-it që kanë vizituar ankuesit në Njësinë Rajonale të Hetimeve nuk i kanë paraqitur ndonjë vërejtje homologëve të tyre të Kosovës as për faktin e arrestimit që kishte ndodhur dhe as për mënyrën se si janë procesuar ankuesit. Ishte e qartë për zyrtarët e EULEX-it se ankuesit ishin informuar për arsyet e arrestimit të tyre. Paraburgimi ishte konfirmuar nga prokurori në të njëjtën ditë dhe ankuesit menjëherë në ditën në vijim ishin sjellë para gjykatës.
35. Sa i përket pretendimeve për keqtrajtim në paraburgim, ShM nuk e vë në pyetje se ajo do të përbente shkelje shumë të rëndë të të drejtave të tyre të njeriut. Ai pohoi se disa raporte të EULEX-it dhe një hetim penal i mëvonshëm tregojnë se një keqtrajtim i tillë ka ndodhur. Sidoqoftë ShM pohoi se kryesit e dyshuar kanë të drejtë të konsiderohen të pafajshëm përderisa të dëshmohet fajësia nga një gjykatë kompetente. Megjithatë ShM argumenton se nëse Paneli gjen se ka ndodhur keqtrajtimi i dyshuar, EULEX-i ka përmblusur obligimin e vet në marrjen e të gjitha hapave të arsyeshëm për të parandaluar atë dhe për të reaguar me hetimin penal që kishte pasuar. EULEX-i ka ndërmarrë hapa të vazhdueshëm për të siguruar se rasti është duke u trajtuar në përputhje me të drejtat e njeriut. Ata kanë monitoruar lëvizjet e ankuesve brenda Kosovës dhe ndërveprimet e tyre me policinë dhe gjykatën. Ata nuk kanë qëndruar me ankuesit në Njësinë Rajonale të Hetimeve, por nga të dhënat në dispozicion, ai ishte vendim i arsyeshëm. Nuk ka asgjë që tregon se kishte ndodhur ndonjë keqtrajtim në atë fazë.
36. EULEX-i nuk ka qenë i pranishëm gjatë asnjërës prej keqtrajtimit të dyshuara. Nëse Paneli gjen se ato kanë ndodhur, EULEX-i nuk ka mundur në mënyrë të arsyeshme ta parashikonte atë. Për më tepër, EULEX-i nuk ka pasur të regjistruar ndonjë incident armiqësor gjatë festimeve të krishtlindjeve në vitet e mëparshme. Prandaj, EULEX-i ka bërë gjithçka që në mënyrë të arsyeshme mund të pritet për të siguruar të drejtat e ankuesve.
37. Në reagimin e tyre ndaj këtyre vërejtjeve, ankuesit pohojnë se ata besojnë që EULEX-i, si garantues kryesor për respektimin e të drejtave të njeriut në Kosovë, ishte i detyruar që të parandalonte shkeljet e të drejtave të tyre themelore, të kryera nga PK-ja, e cila monitorohet nga EULEX-i. Ata theksojnë se EULEX-i ishte në dijeni të arrestimit të tyre dhe kanë mësuar për atë relativisht shpejtë. EULEX-i ka bërë vizitë në Njësinë Rajonale të Hetimeve, ku ata gjetën se nuk kishte asgjë që do të çojë PK-në në një përfundim se ankuesit kishin



kryer ndonjë lloj veprë penale. Sipas mendimit të ankuesve kjo duhet t'i kishte dhënë EULEX-it ide se ata duhet t'i përcjellin veprimet e PK-së më nga afër dhe në atë mënyrë të parandalonin shkeljen e të drejtave të tyre.

38. Ankuesit përfundojnë se të drejtat e tyre themelore të njeriut janë shkelur nga Policia e Kosovës dhe se EULEX-i si garantues kryesor i respektimit të të drejtave të njeriut në Kosovë mban përgjegjësinë për shkak të mos veprimit.

### **Vlerësimi i Panelit**

#### *Mandati i Panelit (Rregulla 25 par. 1 i rregullores së punës)*

39. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të cilat duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
40. Para se të merret parasysh ankesa mbi bazueshmërinë e saj, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranojë ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
41. Nuk është bërë asnjë vërejtje nga palët në lidhje me pranueshmërinë e ankesave.
42. Sipas rregullës 25, paragrafi 1, të rregullores së punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në drejtësi, polici dhe dogana. Paneli nuk shqyrton procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës.
43. Paneli tashmë ka konstatuar në shumë raste se veprimet e prokurorëve të EULEX-it të marra në kuadër të hetimit penal janë pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë dhe për këtë arsye bien në kuadër të mandatit të Panelit (shih, për shembull *Krlic kundër EULEX-it*, nr. 2012-21, 26 gusht 2014, § 23; *Y kundër EULEX-it*, nr. 2011-28, 15 nëntor 2012, § 35). Rrethanat e këtij rasti kanë të bëjnë me veprimet e ndërmarra nga zyrtarët policor të EULEX-it që punojnë në kuadër të divizionit të përforcimit të Misionit.

44. Gjithashtu Paneli ka konstatuar se vetë fakti që operacionet e policisë në atë ditë ishin të udhëhequra nga Policia e Kosovës dhe që kanë hyrë brenda përgjegjesisë kryesore të saj nuk e përjashton faktin se EULEX-i mund të mbahet përgjegjës për veprimet e veta apo dështimet për atë sa ato kanë ndikuar në ushtrimin e mandatit ekzekutiv të EULEX-it. Në rrethana të tilla, Paneli do të marrë parasysh, posaçërisht nëse ndonjë gabim që i atribuohet EULEX-i mund të ketë shkelur apo kontribuar në shkeljen e të drejtave të njeriut të ankuesve (*A, B, C dhe D kundër EULEX-it*, nr. 2012-09 deri më 2012-12, 20 qershor 2013 § 45).

*Pranueshmëria e ankesës sipas nenit 5 të Konventës*

45. Pavarësisht nga çfarë është konsideruar më sipër, Paneli përsërit atë që tashmë e ka konstatuar në shumë raste. Në rrethana të caktuara, juridiksioni i tij përfshijë vendimet dhe aktet e autoriteteve hetimore në hetimet penale edhe kur ato i janë nënshtruar ndonjë shqyrtimi pasues gjyqësor. Paneli është i mendimit se do të ketë juridiksion për të shqyrtuar këto akte dhe vendime ku lënda e akteve dhe vendimeve që i nënshtrohen rishikimit të tillë prek çështjet e të drejtave të njeriut, si për shembull të drejtën e lirisë personale dhe sigurisë brenda kuptimit të nenit 5 të Konventës. Megjithatë, Paneli do të ndërhyjë vetëm nëse dhe kur ankesa për shkelje të të drejtave të njeriut që i atribuohet prokurorit nuk është adresuar plotësisht nga autoritetet kompetente gjyqësore (*Z kundër EULEX-it*, 2012-06, më 10 prill 2013, par. 34). Paneli nuk sheh arsye se pse ky parim nuk duhet të zbatohet gjithashtu edhe për veprimet e policisë së EULEX-it.
46. Duke iu kthyer rrethanave të kësaj lënde, Paneli vëren se ankuesit ishin sjellë para Gjykatës për Kundërvajtje në Prishtinë më 8 janar 2013 dhe ishin liruar në mbrëmjen e asaj dite. Prandaj kësaj gjykate iu ishte dhënë mundësi për të shqyrtuar nëse arrestimi i tyre ishte i ligjshëm dhe i justifikuar në ato rrethana. Megjithatë, asnjëra palë nuk i ka paraqitur Panelit, në mbështetje të argumenteve të tyre, ndonjë kopje të ndonjë dokumenti përkatës.
47. Duke pasur parasysh faktin se ankesa e bërë në bazë të nenit 5 të Konventës nuk ka qenë e vërtetuar siç duhet nga asnjë dokument, vendimtar sa i përket shqyrtimit nëse paraburgimi për të cilin kishte pasur ankesë ishte i ligjshëm dhe i arsyeshëm dhe rrjedhimisht nëse veprimet e EULEX-it në lidhje me këtë ishin në përputhje me standardet e përcaktuara me këtë dispozitë, Paneli e konstaton këtë se është qartas e pabazuar.

*Shkeljet e pohuara të neneve 3, 9 dhe 14 të Konventës*

48. Paneli së pari do të shqyrtoj ankesën sipas nenit 3.
49. Ashtu siç tashmë është parashtruar nga EULEX-i në *Bahadur dhe të tjerët kundër EULEX-it* (2011-02, 14 shtator 2011, § 39) dhe përsëritur

nga Paneli në *Kahrs kundër EULEX-it* (2012-16, më 10 prill 2013, § 26 “Policia e EULEX-it mban kapacitet korrigjues, e cila është një formë e veçantë e pushtetit ekzekutiv. Këto kompetenca mund të përdoren në lidhje me çdo shkelje të të drejtave të njeriut dhe të vendimeve të papërshtatshme operative ose administrative të bëra nga Policia e Kosovës”.

50. Paneli thekson se policët e EULEX-it të pranishëm gjatë ngjarjeve ishin duke vepruar në cilësinë e këshillimit dhe ushtrimit të përgjegjësive për monitorim, udhëzim dhe këshillim (MMK).
51. Paneli më tej thekson se aktivitetet e MMK-së mund të bartin detyrim pozitiv për të vepruar aty ku ndërhyrja e menjëhershme është e domosdoshme në funksion të së drejtës së mbrojtur.
52. Në këtë drejtim, Paneli konstaton të rëndësishme qasjen e zhvilluar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Gjykata), që nënkupton se në bazë të Konventës në disa rrethana të përcaktuara mirë, detyrimi pozitiv u ngarkohet autoriteteve në mënyrë që të ndërmarrin masa parandaluese operative për të mbrojtur një individ. Në këtë drejtim, Gjykata ka vërejtur në kontekstin e lëndëve që lidhen me të drejtën për jetën se “duke pasur parasysh vështirësitë që dalin në detyrat policore në shoqëritë moderne, paparashikueshmërinë e sjelljes njerëzore dhe zgjedhjet operative, të cilat duhet të ndërmerren sa i përket prioriteteve dhe burimeve, një detyrim i tillë duhet të interpretohet në atë mënyrë që nuk imponon barrë të pamundur apo joproporcionale mbi autoritetet. Prandaj, jo secili rrezik i pohuar për jetën mund t’i obligoj autoritetet në obligimet e Konventës në mënyrë që të ndërmerren masa operative për të parandaluar realizimin e atij rreziku. Një tjetër konsideratë e rëndësishme është edhe nevoja për të siguruar që policia të ushtroj kompetencat e veta për të kontrolluar dhe parandaluar krimin në atë mënyrë që respekton plotësisht procesin e duhur dhe garancitë e tjera, të cilat në mënyrë legjitime vendosin kufizime në fushën e veprimeve të tyre për të hetuar krimin dhe për të sjellë fajtorët para drejtësisë, duke përfshirë garancitë e përfshira në nenet 5 dhe 8 të Konventës” (shih, midis autoriteteve të tjera, *Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i datës 28 tetor 1998, § 115 e tutje).
53. Paneli pranon se duke pasur parasysh mandatin e kufizuar të EULEX-it, EULEX-i nuk mund të mbahet përgjegjës për dështimin që të garantoj një mbrojtje efektive të të drejtave të njeriut si të tilla në Kosovë dhe se një barrë e pamundur apo joproporcionale sa i përket detyrave policore nuk mund t’i imponohet Misionit. Është vënë në dukje se megjithatë është obligim i EULEX-it në bazë të Veprimit të Përbashkët të Këshillit për të siguruar që aktivitetet e veta duhet të kryhen në përputhje me standardet ndërkombëtare lidhur me të drejtat e njeriut (shih nenin 3 (i), Veprimit të Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP). Brenda kontekstit të MMK-së, detyrimi për zyrtarët e EULEX-it për të vepruar në mënyrë që të parandalohen shkeljet e të drejtave të njeriut mund të thuhet se lindin atëherë kur ata janë

ballafaquar me një kërcënim të ndonjë shkeljeje të drejtpërdrejtë dhe të rëndë të të drejtave të individit, pavarësisht prej çështjes së të drejtës në fjalë. Natyra e përgjigjes duhet të jetë e përshtatshme për rrethanat dhe nga ana tjetër varet se cila e drejtë apo të drejta ishin në rrezik dhe varet nga serioziteti i kërcënimeve ndaj këtyre të drejtave (krahasoni *Kahrs*, cituar më lartë, §§ 30-31).

54. Megjithatë duke pasur parasysh vështirësitë që hyjnë në detyrat policore në shoqëritë moderne, paparashikueshmëria e sjelljes njerëzore dhe zgjedhjet operative, të cilat duhet të ndërmerren sa i përket prioriteteve dhe burimeve, një obligim i tillë duhet të interpretohet në një mënyrë që nuk imponon barrë të pamundur apo disproporcionale mbi autoritetet. Prandaj jo secili rrezik ndaj të drejtave të njeriut mund t'i imponoj autoriteteve nevojën për të ndërmarrë masa operative për të parandaluar realizimin e atij rreziku (shih *me ndryshimet e nevojshme (mutatis mutandis)*, Osman, cituar më lartë, § 116).
55. Duke iu referuar rrethanave të këtij rasti konkret, Paneli konstaton se policët e EULEX-it nuk ishin të pranishëm gjatë incidenteve dhe vetëm më vonë kanë mësuar rreth tyre. Ata nuk e kanë parë momentin e arrestimit të ankuesve që u zhvillua në një farë distance nga vendi i festimeve, por pasi mësuan rreth saj, i kanë përcjellë në vendin e paraburgimit. Ata kanë monitoruar dhe intervistuar ankuesit, të cilët duket se në atë moment nuk kanë pasur asnjë ankesë. Ata ishin të kënaqur se ankuesit ishin trajtuar mirë dhe në përputhje me ligjin. Paneli pranon se në kohën e vizitës së EULEX-it, ankuesit janë dukur të jenë mirë me shëndet dhe nuk janë ankuar për ndonjë keqtrajtim.
56. Policët e EULEX-it nuk kanë qenë të pranishëm në gjykatë gjatë seancave të ankuesve dhe as nuk kanë qenë në dijeni për ndonjë ankesë gjatë asaj kohe.
57. Duke mësuar rreth keqtrajtimit të pretenduar të ankuesve, policët e EULEX-it i kanë intervistuar ata dhe i kanë këshilluar lidhur me mënyrat e mundshme që kryesit e veprës të hetoheshin.
58. Sipas mendimit të Panelit, ankuesit nuk kanë treguar për asnjë fazë vendimtare të zhvillimit të ngjarjeve, të cilat çuan deri në keqtrajtimin e tyre, kur mund të thuhet se zyrtarët e EULEX-it e dinin ose duhej të dinin që mirëqenia e tyre ishte në rrezik (shih, *a contrario*, A, B, C dhe D, § 47). Edhe pse në ankesën e tyre fillestare ata kanë deklaruar se “gjatë gjithë kohës [në paraburgim] janë keqtrajtuar fizikisht dhe mentalisht”, parashtresat e tyre të mëtuqeshme, raportet e EULEX-i dhe aktakuza (e ngritur vetëm kundër zyrtarëve të ROSU-së, të pranishëm në ditën e seancave) do të sugjeronin se nuk ka pasur keqtrajtim deri pak para se ankuesit të transportoheshin për në seancat e tyre.

59. Për më tepër, në të kundërtën me lëndët *A, B, C dhe D*, nuk është treguar se ishte pamjaftueshmëria e burimeve të mbledhura nga EULEX-i për t'i monitoruar ngjarjet e ditës së krishtlindjeve, që ka kontribuar në shkeljet e supozuara të të drejtave të ankuesve (krahasoni *A, B, C dhe D*, § 61). Këto pretendohet se janë kryer nga zyrtarët e PK-së, brenda qendrës së paraburgimit. Paneli konstaton se nuk është as e nevojshme e as nuk mund të jetë e mundur për stafin e EULEX-it që të jetë i pranishëm pranë PK-së për të monitoruar veprimet e tyre në çdo kohë. Paneli konsideron se policia e EULEX-it ka bërë gjithë atë çfarë ka qenë e mundur në ato rrethana.
60. Më tej Paneli thekson se janë ndërmarrë hapa hetimor për t'i adresuar shkeljet e dyshuara të të drejtave të njeriut të përmendura në ankesa. Një hetim i përbashkët nga PK-ja dhe EULEX-i nën mbikëqyrjen e një prokurori të EULEX-it kishte nisur, ku dhe kryesit e veprës janë akuzuar. Aktualisht pranë Gjykatës Themelore të Prishtinës është duke u zgjidhur një lëndë kundër tyre. Nuk është e nevojshme që Paneli për qëllimet e kësaj lënde rreth pretendimeve për gabime nga ana e EULEX-it të ketë në dispozicion të vet informacionin rreth meritave të çështjes penale kundër zyrtarëve të Policisë së Kosovës.
61. Duke pasur parasysh rrethanat e rastit, të cilat janë parë si një tërësi, Paneli është i mendimit se situata për të cilën ka pasur ankesë, nuk ka përbërë shkelje të nenit 3 të Konventës që i atribuohet EULEX-it.
62. Në bazë të të gjeturave sipas nenit 3, Paneli konsideron se nuk është e nevojshme që të shqyrtohen ankesat sipas neneve 9 dhe 14 të Konventës, pasi nuk ngritët ndonjë çështje veç e veç në këto dispozita.

## **PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI**

1. *Shpall* ankesat sipas nenit 5 të Konventës të papranueshëm pasi qartas janë të pabazuara;
2. *Konstaton* se nuk ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës;
3. *Konstaton* se nuk është e nevojshme të shqyrtohet lënda sipas neneve 9 dhe 14 të Konventës.

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese